

Nr.21

ISSN 2521-831X

BULETINI MUJOR KLIMATIK

Shtator 2018

Universiteti Politeknik i Tiranës

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit & Mjedisit

Tirana © 2018





BULETINI MUJOR KLIMATIK

Shtator 2018

Nr. 21

Përmbledhje. Muaji Shtator 2018 ishte në fakt një zgjatim i stinës së verës për këtë vit. Temperaturat mesatare të ajrit shënuan vlera mbi normë me rreth $+1.9^{\circ}\text{C}$, ndërsa më të larta këtë shmangie krahasuar me normën e kishin vlerat e temperaturave maksimale me $+2.9^{\circ}\text{C}$. Situata e reshjeve të pakta dhe prania e thatësisë u ndjenë në mbarë vendin. Reshjet nuk shënuan më shumë se 15% të nivelit të normës, ndërkohë ato u vrojtuan në rreth 1/3 e ditëve me reshje referuar treguesit të ditëve me reshje mbi pragun 1.0mm. Gjithashtu jepen disa konsiderata për stinën e veçantë të verës 2018. Temperaturat e ujit në sipërfaqe të Deteve Adriatik dhe Jon vijuan të ruajnë vlera të larta dhe patën një shmangie pozitive kundrejt normës. Në rubrikën e informacioneve shkencore jepet një panoramë mbi fituesit dhe humbësit nga ndryshimet klimatike.

Summary. The month of September 2018 was in fact an extension of the summer season for this year. Average air temperatures marked above the norm at $+1.9^{\circ}\text{C}$, while higher this deviation compared to the norm had the maximum temperature values of $+2.9^{\circ}\text{C}$. The situation of scarce rainfall and the presence of drought felt throughout the country. Precipitation did not mark more than 15% of the rate level, meanwhile they were observed at around 1/3 of the precipitation day's index over the threshold 1.0mm. Also are given some considerations for the special summer season 2018. Water temperatures on the Adriatic and Ionian Seas surface continued to preserve high values and had a positive deviation from the norm. The scientific information section provides an overview of climate change winners and losers.

SITUATA SINOPTIKE

Muaji shtator 2018 ishte një muaj shumë i qetë, pasi u dominua nga sisteme anticiklonare, pra moti ishte shumë i qëndrueshëm, me shumë pak reshje. Ngjarja kryesore e muajit, në fakt, ishte një ardhje e shpejtë e masave ajrore arktike në datën 24, shprehur me një front të ftohtë në veri të vendit paraqitur dhe në figurën Nr.1.

Kjo solli një rënie të shpejtë të temperaturave, por edhe erëra të forta për shkak të një gradienti barik shumë të theksuar. Këto të fundit e rritën ndjeshëm fenomenin e zjarreve në pyje. Ky fenomen i rrezikshëm ishte, madje, më i lartë sesa në 3 muaj e verës së bashku.

Figura Nr.1. - Situata sinoptike e datës 24 shtator 2018, 12:00 UTC.

Nga ngjarjet kontinentale ajo më e rëndësishme që u vërtetua kësaj here jo shumë larg vendit tonë ishte stuhia e vërtetuar nga data 28 shtator deri më 1 tetor 2018, e cila preku territorin e Greqisë kryesisht e më pas atë të Turqisë. Kjo stuhi “Medicane” dhe trajektorja e lëvizjes së saj paraqitet në figurën Nr. 2.





Figura Nr.2. - Situata e lëvizjes së stuhisë Mesdhetare “Medicane Zorba” gjatë datave 28 shtator deri më 1 tetor 2018.

Figura Nr.3. – Pamje satelitore e situatës së stuhisë Mesdhetare më datë 29 shtator 2018.

Kjo stuhi e rrallë dhe e fuqishme nisi më datën 28 shtator 2018, duke gjeneruar përmytje kryesisht në territorin e Greqisë sidomos më pranë brigjeve detare. Kjo stuhi e emërtuar me emrin “Zorba” preku brigjet detare të Kalamatës, duke lënë gjurmë të tjera më pas në brigjet e Peloponezit e deri në qytetin e Pylos. Pasojat e vërtetuar konsistuan në humbjen e 3 jetëve njerëzore, rrebeshe të forta shiu dhe përmytje me pasoja dhe dëme ekonomike.

Kjo stuhi u emërtua si “Medicane” për arsye si të vend vërtetimit të saj në detin Mesdhe ashtu si dhe për nga cilësitë e ngjashme me ato të stuhive tropikale.

Stuhi të tilla vërtetohen një apo dy herë në vit, përgjithësisht gjatë muajit shtator ose tetor, kur temperaturat e sipërfaqes së ujit në dete janë të larta.



KARAKTERISTIKAT KRYESORE METEOROLOGJIKE TË MUAJIT: SHTATOR 2018 DHE DISA KONSIDERATA MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE

TEMPERTAURAT E AJRIT – Në muajin shtator 2018, shënuan vlera mbi normë pothuajse në të gjithë territorin e vendit tonë me afro **+1.9°C**. Në figurën Nr. 4 dhe Nr. 6/1÷6/12 paraqiten të dhënat e temperaturës mesatare të ajrit të përzgjedhura për 30 vendmatje meteorologjike nga zonat dhe nënzonat e ndryshme klimatike të vendit tonë.




Figura Nr. 4. – Vlerat mesatare të temperaturës së ajrit për muajin shtator 2018 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat përkatëse të normës 1961÷1990.

Ndërsa, në shkallë kontinentale vlerat e temperaturave mesatare të ajrit për muajin shtator 2018 paraqitet në figurën Nr. 5, ku jepen dhe anomalitë krahasuar me periudhën 1981÷2010. Hapësira e vendit tonë sipas këtij krahasimi ruan vlera 1÷3°C mbi vlerën shumëvjeçare të periudhës 1981÷2010.
















Figura Nr.5. – Vlerat e temperaturës mesatare të ajrit për muajin shtator 2018 për kontinentin European dhe anomalitë përkatëse ndaj periudhës shumëvjeçare 1981÷2010, sipas NOAA-s.

Në vijim të ardhjes së frontit të ftohtë atmosferik më datë 24 shtator (shih dhe figurën Nr. 1) u shënuan një ulje e përkohshme e temperaturave të ajrit, por që nuk zgjati më shumë se 48 orë, pasi më pas masat e ngrohta ajrore përsëri u rikthyen në vendin e mëparshëm duke risjellë vlera të larta të temperaturave. Një paraqitje më e detajuar e kësaj ecurie me vlera ditore të temperaturave minimale e maksimale të ajrit për 12 vendmatje meteorologjike jepet në figurat Nr. 6/1÷6/12.

Situata e temperaturave maksimale të ajrit në shkallë kontinentale e detajuar sipas 4 javëve jepet në figurën Nr.8, ku vendi ynë vijojë të jetë me temperatura të larta. Ato ruajtën qendrueshmëri gjatë gjithë kohës, me vlera rreth **+2.9°C** mbi normë (shih dhe figurën Nr.7).

Vlerësime për ecurinë e temperaturës së ajrit dhe reshjet (figurat në vijim Nr. 6/1÷6/12) në disa prej vendmatjeve meteorologjike të Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik për muajin: Shtator 2018.






Figura Nr. 7. – Vlerat mesatare të temperaturës maksimale të ajrit për muajin shtator 2018 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat përkatëse të normës.




Figura Nr.8. – Vlerat mesatare të temperaturave maksimale të ajrit për kontinentin Europian për disa nga javët e muajit shtator 2018, sipas NOAA-s.

Me vlera mbi normë, por më të moderuara me vetëm **+0.9°C** temperaturat minimale ruajtën nivele të larta edhe gjatë muajit shtator 2018 në pjesën më të madhe të vendmatjeve meteorologjike që u analizuan.

Në figurën Nr. 9 jepet një tablo grafike për disa nga vendmatjet meteorologjike të përzgjedhura për këtë muaj, sa i takon temperaturave minimale të ajrit.




Figura Nr.9. – Vlerat mesatare të temperaturës minimale të ajrit për muajin shtator 2018 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat përkatëse të normës.

NETËT TROPIKALE Natyrisht një stinë vere e tejzgjatur si kjo këtij viti, nënkulon se dhe netët tropikale (netët kur temperatura minimale e ajrit nuk zbret nën prapun 20.0°C) ishin të pranishme dhe gjatë muajit shtator 2018. Në vijim në figurën Nr.10 jepet një pasqyrë e këtij treguesi për vitet e fundit dhe vlerat përkatëse të normës për vendmatjen meteorologjike të Tiranës.




Figura Nr. 10. – Numri i netëve tropikale për muajin shtator, për vitet 2002 deri 2018, për vendmatjen meteorologjike të Tiranës si dhe vlerat e normës.

Duke analizuar gjithë periudhën kur janë vërtetuar netët me temperatura mbi prapun 20°C, të cilat nisin që nga data 28 prill 2018 rezulton se deri në fund të muajit shtator të këtij viti ky tregues shënon një vlerë rekord, të vërtetuar vetëm një herë më parë në të shkuarën, në vitin 2012, natyrisht ende pa mbaruar dhe muaji tetor 2018. Paraqitja grafike e këtij treguesi jepet në figurën Nr. 11.





Figura Nr.11. - Numri i netëve tropikale për muajt prill ÷ shtator 2018, për vitet 2012 deri 2018, për vendmatjen meteorologjike të Tiranës si dhe vlerat e normës (treguar me ngjyrë jeshile).

KLIMA URBANE

Muaji shtator 2018 për Tiranën vijoi të përcjellë temperatura të ajrit mbi normë, me një shmangie prej **(+2.4°C)**, duke evidentuar një vlerë më të lartë kundrejt vendmatjeve të tjera meteorologjike (+1.9°C), të cilat nuk e kanë impaktin e efektit të “ishullit urban” siç e ka kryeqyteti.

Figura Nr.12. – Të dhënat e temperaturës mesatare të ajrit për muajin shtator për vitet 2012÷2018 dhe vlerat e normës referuar periudhës 1961÷1990 për vendmatjen meteorologjike të Tiranës.



NDRYSHIMET KLIMATIKE

Në këtë buletin do të ndalemi kryesisht në situatën e veçantë të vlerësuar për verën e këtij viti.

A ka mbaruar stina e Verës për vitin 2018 ?

Ende pa mbaruar muaji tetor 2018 mund të evidentohet një situatë tepër e veçantë e këtij viti, kur periudha e stinës së verës (ditë me temperatura të ajrit sa ato të muajve qershor, korrik e gusht, sipas normës) u vrojtuan për një periudhë më të gjatë kohore si përpara fillimit të stinës së verës dhe po ashtu edhe në mbarim të saj.

Në figurën Nr. 13 jepet një tablo grafike e vlerave të temperaturave të ajrit për muajt e verës, por dhe për ato që para e pas prijnë këtë stinë, sipas normës (pika jeshile dhe vijë të kuqe të ndërprerë) si dhe vlerat e vrojuara gjatë vitit 2018 (pika të kuqe të lidhura me vijë të kuqe të plotë) për vendmatjen meteorologjike të Tiranës.













Figura Nr.13. – Të dhënat e temperaturave të ajrit për vendmatjen meteorologjike të Tiranës për muajt prill deri shtator 2018 si dhe vlerat përkatëse të normës.

Gjithashtu aty evidentohen dhe datat e para, (me ngjyrë violet), kur u shënuan vlera 25.5°C, 24.5°C dhe 26.5°C (për datat 28, 29 dhe 30

prill), të cilat të gjitha në vijimësi me muajin maj e bëjnë këtë stinë vere tepër të gjatë, sa i takon ecurisë së temperaturave të ajrit. Të gjithë muajt kush më shumë kush më pak ruajnë vlera mbi normë. Shmangien më të vogël, por përsëri mbi normë e shënon muaji korrik 2018.

Figura Nr.14. – Të dhënat e temperaturave të ajrit për vendmatjet meteorologjike të Tropojës, Koplikut, Shupenzës, Kurbneshit, Belshit, Librazhdit, Prrenjasit, Nivicës dhe Potomit për muajt prill deri shtator 2018 si dhe vlerat përkatëse të normës.






Dy përfundime interesante !

Nga një analizë më e plotë jo vetëm për vendmatjen meteorologjike të Tiranës, por dhe për disa vendmatje të tjera meteorologjike nga zona e nënzona të ndryshme klimatike të vendit tonë (papaqitur në figurën Nr. 14), të cilat e kanë impaktin e “*ishullit urban*” më të kufizuar ose ruajnë karakteristikat ashtu si dhe 30 vite më parë, evidentohet dukshëm fakti i kësaj situate ndryshueshmërie dhe vlerash mbi normë, që paraqitet në figurën Nr.15.

Figura Nr.15. – Të dhënat e diferencave të temperaturave të muajit gusht me ato të muajit korrik 2018.

Përfundimi i parë ka të bëjë me faktin që për herë të parë shënohet vlera më e lartë e temperaturës mesatare të ajrit në muajin gusht dhe jo në korrik, që sipas historisë së vrojtimeve meteorologjike ka të evidentuar nga pikëpamja klimatike, pikërisht muajin korrik me vlerat më të larta në ecurinë vjetore.

Përfundimi i dytë ka të bëjë me kohëzgjatjen dhe vijimësinë e kësaj “*stine vere*”, e cila për këtë vit (2018) ende nuk ka mbaruar (ndonëse jemi në ditët e para të muajit tetor, pikërisht kur po përgatitet dhe ky buletin klimatik për muajin shtator 2018) dhe vijnë të ruhen vlera të larta të temperaturave të ajrit.



RESHJET ATMOSFERIKE : Gjatë muajit shtator 2018 u vrojtuan reshje të pakta në mbarë territorin. Reshjet e këtij muajit ishin në nivel të 15%, referuar vlerave të normës. Ato u vrojtuan në vetëm rreth 28% të numrit të ditëve me reshje mbi pragu 1.0 mm. Në figurën në vijim jepen

Reshjet: Muaji Shtator 2018 dhe vlerat e normës 1961-1990

-85 %


Reshjet në mm

Reshje Shtator Norma
Reshje Shtator 2018

Vendmatjet meteorologjike

Vendmatjet meteorologjike	Reshje Shtator Norma (mm)	Reshje Shtator 2018 (mm)
Balish	55	2
Besh	55	20
Bisht	35	2
Bishit	90	10
Bushat	120	30
Cukë	78	30
Dajç-Bunë	120	32
Dajç-Zadrinë	110	2
Darçis	55	3
Durrës	62	25
Durrës	58	3
Fratar	48	2
Faqah Kos	90	12
Gërn	108	12
Gorica e Madhe	55	2
Goçali (Kukes)	65	2
Hoshitë	112	2
Hot	100	18
Jaronisht	70	12
Kallmet	100	42
Kamërdol	82	42
Koplik	118	15
Korçë	42	18
Kranis	52	8
Krye	95	35
Kurje	102	5
Kukës	65	5
Kurush	88	35
Larush	70	25
Likaball	62	25
Luganës	40	2
Longo	80	2
Mogës	100	3
Pepon	55	2
Përingsht	50	2
Petëbil	85	8
Petëbil	82	15
Petësh	68	25
Qarrinë	95	20
Rajsh	142	15
Shupkaz	50	2
Shqip	70	15
Strajë	78	65
Tenësis	62	65
Tiranë	80	8
Tropojë	78	5
Tropojë	85	5
Vermosh	112	20
Zarcan	60	2

Në shkallë kontinentale u ruajt një situatë me bilanc negativ sa i takon reshjeve, e cila pasqyrohet dhe në hartat e dhëna në figurën Nr.17, ku vendi ynë dallon për vlera rreth minus 100 mm nën vlerat e periudhës shumëvjeçare 1981÷2010. Kjo situatë thatësire siç shihet në figurën Nr. 17 preku pjesën më të madhe të kontinentit European.

[illegible]

BULETINI MUJOR KLIMATIK



Figura Nr.19. - Reshjet maksimale 24 orëshe për disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë për muajin shtator 2018.

STUHITË - Muaji shtator 2018 u karakterizua nga një numër i lartë i stuhive sipas qendrës eksperimentale të monitorimit dhe parashikimit european ESTOFEX, gjithsejt 22 në total; ku 11 ishin të kategorisë së parë dhe 11 të kategorisë së dytë. Në figurën në vijim Nr.20 jepet një paraqitje grafike e tyre (për kategorinë e dytë), duke përfshirë të gjithë muajt nga janari deri shtator 2018, si vlerat mesatare të periudhës 2006 deri më 2017.





Figura Nr.20. Numri i stuhive të kategorisë 2, sipas muajve për periudhën 2006÷2017 si dhe për muajt: janar deri në shtator 2018, referuar sistemit ESTOFEX.

Një situatë e veçantë stuhie e vërtetuar jo larg vendit tonë, që preku pjesën JL të Greqisë, i takon datës 28÷30 shtator 2018, trajektoria e së cilës u evidentua në fillim të këtij buletini, dhënë në figurën Nr. 2. Situata e pritshme për zhvillimin e kësaj stuhie duke filluar nga data 28 shtator 2018 pasqyrohet në figurën në vijim Nr. 21.

Figura Nr.21.
Situata e pritshme për stuhi të kategorive 1, 2 dhe 3 e vlerësuar më datë 28 shtator 2018 për dy ditët në vijim në kontinentin European.



DETET ADRIATIK DHE JON

Masat ujore gjatë muajit shtator 2018 vijuan të ruajnë temperatura mjaft më të larta se vlerat e normës. Pjesa më e madhe e detit Mesdhe në sipërfaqe shënoi temperatura nga 25 deri 30°C rreth 2.5°C deri 4°C më e lartë se vlerat shumëvjeçare. Anomalitë më të theksuara në Mesdhe u paraqitën në pjesët veriore në brigjet e Francës dhe të veriut të Italisë (deti i Liguras), në të cilët u shënuan 3÷4°C vlera mbi mesataren. Gjithashtu shumë i ngrohtë ishte dhe deti Adriatik me rreth 2.5÷3.5°C mbi mesataren. Në tërësi mund të thuhet se i gjithë Mesdheu ishte mbi normë. Temperaturat e larta të sipërfaqes së ujit ndikojnë në rritjen e potencialit dhe ashpërisë së stuhive dhe shtrëngatave për muajt në vijim të vjeshtës apo fillimit të dimrit. Në figurën e Nr. 22 jepet situata e temperaturave në sipërfaqe të ujit më datë 11.09.2018, ndërsa në figurën Nr. 23 anomalitë përkatëse kundrejt mesatares, të cilat dukshëm evidentojnë masa ujore më të ngrohta se dekada më parë.




Figura Nr. 22. – Vlerat e temperaturës së sipërfaqes së ujit në Detin Mesdhe më datë 11 shtator 2018.




Figura Nr. 23. – Anomalitë e temperaturës së sipërfaqes së ujit në Detin Mesdhe më datë 11 shtator 2018 të krahasuara me ato të periudhës 1982-2012. Data: CNR MED.

Reshjet & Temperaturat

- Në vijim jepen disa vlerësime afatmesme dhe afatgjata mbi kushtet e pritshme meteorologjike mbi hapësirën e kontinentit European, të cilat evidentojnë se për periudhën tre mujore janar, shkurt, mars 2019, sa i takon regjimit të reshjeve ato do të vijojnë të ruajnë një tendencë me vlera pranë normës, kur është fjala për vendin tonë (shih dhe figurën Nr.24), ndërsa temperaturat paraqesin shmangie të pritshme mbi normë (shih figurën Nr. 25), sipas emetimeve më të fundit të muajit tetor 2018.




Figura Nr.24. – Parashikimi i probabiliteteve për reshjet atmosferike për muajt:
Janar, Shkurt, Mars 2019.




Figura Nr.25. - Parashikimi i probabiliteteve për temperaturat e ajrit për muajt:
Janar, Shkurt, Mars 2019 (emetim i muajit tetor 2018).



IGJEUM
2018

FITUESIT DHE HUMBËSIT NGA NDRYSHIMET KLIMATIKE

Ecuria vjetore e PBB për
frymë për një "Skenar A" me
ndryshim +2°C.

- Nga +1% deri në +2%
- Nga +0.5% deri në +1%
- Nga 0 deri në +0.5%
- Nga -0.5% deri në 0
- Nga -1% deri në -0.5%
- Nga -2% deri në -1%
- I pa përcaktuar

+4°C

Është minimumi i ngrohjes
globale të paralajmëruar në
qoftëse nuk merret asnjë masë
për zvogëlimin e emetimeve.

-5%

Është shmangia e rritjes
botërore për një ngrohje
prej 1.5°C deri në 2°C.

75cm

Është niveli i ngritjes së ujit
në dete sipas disa autorëve
në vitin 2100. Efektet e
kësaj dukurie nuk janë
mbajtur në konsideratë në
treguesin e PBB.

1 Rusia. Fituesi i madh.

Me një përshejtim të rritjes prej 1.4%, në kontekstin e një ngrohje prej 2°C; Rusia e ftohtë do të përfitonte nga ngritja e temperaturave duke ekonomizuar në faturën energjetike si dhe duke përfituar nga përmirësimi i rendimenteve të kulturave bujqësore.

Një ngrohje prej 2°C do të përcjellë në shkallë globale një impakt të fortë ekonomik në të gjithë botën. Por, studimet e fundit tregojnë se mbi të gjitha do të theksohen pabarazitë:

vendet më të ftohta do të përfitojnë, ndërsa vendet e nxehta do të jenë humbësit më të mëdhenj.

Nga kjo rezulton të kemi një paqëndrueshmëri më të madhe të botës ?

2 Kanadaja. Eldorado e së ardhmes? Vend demokratik, i pasur dhe akoma pak i populluar. Kanadaja do të përfitonte 1% nga rritja e temperaturave sipas "Skenarit A" me 2°C. Me këto cilësi presioni emigrues do jetë nga më të lartët në botë. Si do ti bënin ballë 36 milion banorët e Kanadasë ?

3 Brazili. Me një rënie neto. Ky gjigant rrezikon të vuajë një degradim të pyjeve të Amazonës, të shënoj një ulje të rendimenteve në bujqësi, pa folur për pasiguritë, që lidhen me shëndetin si pasojë e ngrohjes klimatike.

4 Mali. Një humbës i madh. Si shumica e vendeve të Saheliene, Mali një vend pak i industrializuar, që varet shumë nga bujqësia do të preket mjaft nga ngrohja globale.


5 Franca. Një bonus i mbajtur. Me një bonus të vogël rritjeje mesatarisht prej afro 0.2% Franca do të përfitonte lehtësisht nga një ngrohje pak a shumë si gjithë pjesa tjetër e Evropës, pavarësisht nga diferencat midis zonave apo sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Nëse rritja e temperaturave i kalon +2°C ky bonus rrezikon të bëhet negativ.

6 SHBA. Në ekuilibër. Impaktet në Jug dhe JP të vendit që është me zona të thata do të ekuilibrohen me përmirësimet në zonat veriore të ftohta. Por duhet thënë se dëmet e pritshme nga ngritja e nivelit të dete që janë tepër të kushtueshme nuk janë përfshirë në këtë vlerësim.

7 Kina. Bilanc neutral. Impakti në zonat e thata kompensohet gjithashtu dhe këtu nga efektet në zonat e ftohta. Për më tepër industrializimi i shpejtë i vendit e ka ulur varësinë e tij nga bujqësia.

8 India. Impakte preokupante. Vend mjaft i prekshëm nga dukuritë ekstreme, i ekspozuar ndaj risqeve ciklonike, me zona të gjera të thata si dhe me popullsinë indiane tepër të madhe, rrezikon të jetë tepër i prekur nga ndryshimet klimatike.

9 Mongolia. Një ndihmesë e mirëpritur. Një vend malor dhe me akullnaja, do të përfitojë mjaft nga ngrohja globale. Por ky vend i varfër dhe pak i populluar nuk peshon aspak në ekuilibrin ekonomik të botës.



Një efekt negativ është shumë i mundshëm të ndodhë.

Me një ngrohje prej 2°C trajektorja më e mundshme është ajo e zvogëlimit të rritjes nga ditët e sotme deri në vitin 2100 me 13%. Vargu i probabiliteteve është tepër i gjerë duke përcjellë kështu një pasiguri jo të neglizhueshme. Ndërsa probabiliteti i një rritje të pandryshuar ose pozitive është nën 5%.

Për të lexuar buletinet e tjera jeni të mirëpritur të vizitoni faqen përkatëse, duke klikuar në link-un e IGJEUM-it.

To read the other bulletins you are welcome to visit the respective web site, by clicking on the link of IGEWE.



<http://www.geo.edu.al>

Editorial Board:

Prof.Dr. Petrit ZORBA - Head of the Department of Climate and Environment UPT – IGEWE

Prof.Dr. Sylë TAHIRSYLAJ - University of Prishtina – Republic of Kosova.

Dr. Elvin ÇOMO - Member of the Department of Climate and Environment UPT – IGEWE

Subject Editors (Co-Editors):

Dr. Entela Gavroçi, Institute of Applied Nuclear Physics, Tirana University, Albania.

External Reviewers:

Dr. José A. GUIJARRO - AEMET – Madrid, Spain.

Editorial Board approved by the Director of IGEWE – Prof.Assoc.Dr. Fatos HOXHAI

Ky buletín u realizua me kontributin e punonjësve të Departamentit të Klimës & Mjedisit të IGJEUM sipas rubrikave si vijon:

This bulletin has been realized by the staff contribution of the Department of Climate & Environment by rubrics as follow:

Data digitalization: Dr. A.Hasimi, Dr. E.Çomo, Dr. A.Bardhi, Ing. A. Gjoni & St. Msc. V. Dervishaj.

Data control, verification and elaboration by appropriate software: Prof. P. Zorba, Ing. A. Gjoni.

Evaluation of monthly synoptic situation: M.Sc. M. Marku, Prof. P. Zorba.

Evaluation of monthly meteorological characteristics and climate change: Prof. P. Zorba.

Scientific information about winners and losers of climate change: Prof. P. Zorba.



“Buletin Mujor Klimatik”
Departamenti i Klimës dhe Mjedisit
IGJEUM-UPT.
Tiranë © 2018.

